

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN  
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE  
INFORMATION AND  
DATA PROTECTION  
COMMISSIONER



AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI  
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST  
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY

Nr. 842 Prot., datë 21. 4. 2022

Nr. 236 Prot., datë 21. 04 2022

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

MIDIS

**KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE  
MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**DHE**

**AGJENCISË PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI TË  
REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale i Republikës së Shqipërisë dhe Agjencia për Informim dhe Privatësi e Republikës së Kosovës,

Në vijim të referuara si “Palët”,

- **Të vendosur** në përpjekjet e tyre për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore në tërësi dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale si dhe qasjen në dokumente publike në veçanti.
- **Të bindur** se kjo Marrëveshje do të zhvillojë dhe forcojë marrëdhëniet midis dy autoriteteve homologe, sipas interesave të përbashkëta;
- **Duke rikujtuar** Rezolutat e Konferencave Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë (ICDPPC) dhe Deklaratën e Montreux-së e cila nxit autoritetet ligj-zbatuese të privatësisë të bëjnë më tepër përpjekje, midis së tjerash, për të mbështetur bashkëpunimin ndërkombëtar për zbatimin e ligjit;

Pajtohen për sa vijon:

## **Neni 1** **Qëllimi dhe Objekti**

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është nxitja e bashkëpunimit për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin prej saj, të cilat ndihmojnë në arritjen e objektivave që kanë institucionet si palë nënshkruese të saj. Pavarësisht sa parashikohet në mënyrë të detajuar në pikat më poshtë, zbatimi është subjekt zhvillimi i vazhdueshëm dhe Palët mund ta zgjerojnë apo shtrijnë atë në aspekte dhe fusha që mund të lindin gjatë zbatimit praktik të Marrëveshjes.

Bashkëpunimi do të vijojë mbështetur në këtë Marrëveshje, me vëmendje të veçantë tek fushat thelbësore në vijim:

- Ndërmarrjen e veprimeve për njohjen e ndërsjellë si shtete me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale (*adequacy*), me qëllim miratimin e vendimeve reciproke mbështetur dhe si rezultat i analizës së kuadrove rregullatorë dhe praktikave përkatëse;
- Shkëmbimin e ekspertizave, eksperiencave dhe praktikash të mira me synimin për të konsoliduar aktivitetet përkatëse të secilit autoritet në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe të drejtës për informim në lidhje me dokumentet zyrtare;



- Në zbatim të sa më sipër, Palët marrin përsipër që të organizojnë takime pune të përbashkëta në përputhje me nevojat dhe në kontekstin e procedurave specifike të trajtimit të ankesave në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe qasjes në dokumente publike/të drejtën e informimit, sipas kësaj Marrëveshje dhe në intervalet kohore të caktuara;
- Palët bien dakord që të ndajnë me njëra - tjetrën praktika (rekomandime, vendime apo akte të tjera finalizuese të hetimit administrativ/inspektimeve dhe kontrolleve) të cilat i konsiderojnë me interes për ndërtimin e jurisprudencës në secilën fushë dhe që mund të kenë ndikim dhe t'i vijjnë në ndihmë zgjidhjes së rasteve praktike për Palën tjetër;
- Monitorim dhe shkëmbim të rasteve praktike të gjykatave ndërkombëtare si Gjykata Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut apo Gjykata Evropiane e Drejtësisë lidhur me çështje që janë me interes për fushat e mbuluara nga secili autoritet;
- Asistencë në hartimin e raporteve të aktiviteteve të përbashkëta të zhvilluara sipas dhe për zbatim të kësaj Marrëveshje;
- Komunikim dhe shkëmbim informacioni mbi përditësimin e kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe qasjen në dokumente publike/të drejtën e informimit në të dy vendet;
- Bashkëpunim për shkëmbimin e njohurive, informacionit dhe praktikave në kontekstin e harmonizimit të legjislacioneve me *acquis*-në e BE-së;
- Vizita studimore, takime periodike në nivelin menaxherial, profesional dhe shkëmbim personeli në përputhje me qëllimin dhe për nevojat të zbatimit të kësaj Marrëveshje;
- Lobimin për ndihmë të Agjencisë për Infomim dhe Privatësi për anëtarësim në organizata ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe të drejtën e informimit/qasjen në dokumente publike.

## **Neni 2**

### **Procedurat e Bashkëpunimit**

Për qëllimin e kësaj Marrëveshje, secila Palë do të emërojë një ose më shumë pika kontakti.

Pikat e kontaktit do të angazhohen për zbatimin e kësaj Marrëveshje.

Asnjë informacion i transferuar/shkëmbyer nuk do të përhapet drejt palëve të treta pa pëlqimin e qartë me shkrim të Palës transferuese.

Pikat e kontaktit të të dyja palëve do të jenë në dispozicion në çdo kohë për komunikim dhe koordinim me Palën tjetër.

### **Neni 3**

#### **Koherenca e takimeve mes palëve'**

Përfaqësuesit e palëve respektive do të takohen rregullisht dhe jo më pak se dy herë në vit për t'u konsultuar për sa i përket zbatimit të kësaj Marrëveshje, në mënyrë që të vendosin prioritetet e bashkëpunimit brenda kësaj kornize për vazhdimin e të njëjtit akt dhe shkëmbimin e pikëpamjeve që kanë të bëjnë me fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe qasjes në dokumente publike.

### **Neni 4**

#### **Analiza e zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit**

Palët do të shqyrtojnë në baza vjetore, rezultatet e bashkëpunimit të tyre sipas kësaj Marrëveshje. Sipas nevojës, palët do të ndërmarrin hapa për përmirësimin e bashkëpunimit dhe do të bëjnë propozime të përshtatshme për të ndryshuar fushën e veprimit të kësaj Marrëveshje.

### **Neni 5**

#### **Konfidencialiteti**

Gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshje, Palët mund të shkëmbejnë informacion të konsideruar konfidencial. Të gjitha të dhënat e shkëmbyera midis Palëve do të konsiderohen konfidenciale dhe do të administrohen nga personat e caktuar nga Palët në këtë Marrëveshje, me përjashtim të rastit kur përcaktohet ndryshe me shkrim.

### **Neni 6**

#### **Dispozitat Përfundimtare**



Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Palët dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë kohore të pacaktuar.

Kjo Marrëveshje nuk përbën marrëveshje ndërkombëtare dhe nuk krijon të drejta dhe detyrime që rrjedhin nga e drejta ndërkombëtare.

Secila palë mund të ndërpresë marrëdhëniet e përcaktuara në këtë Marrëveshje duke e njoftuar me shkrim Palën tjetër.



Nënshkruar në Tiranë, më 21 Prill 2022, në 2 (dy) kopje, ku të gjitha kopjet janë njësoj origjinale.

Besnik **DERVISHI**



*KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE*

Krenare **SOGOJEVA-DËRMAKU**



*KOMISIONERE PËR INFORMIM DHE  
PRIVATËSI*